



— RAPORT MONITORIMI —

PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI KORRUPSIONIN NË SHQIPËRI

PRILL 2022

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



PËRMBAJTJE

1. Analiza e kontekstit
2. Metodologjia dhe të dhënat demografike
3. Analiza e detajuar e të dhënave të sondazhit
 - 3.1 Besimi i qytetarëve ndaj administratës publike
 - 3.2 Digjitalizimi i shërbimeve dhe korrupsioni
 - 3.3 Masat anti-korrupsion, efektiviteti dhe njohuritë e qytetarëve
 - 3.4 Nivelet e korrupsionit dhe e ardhmja sipas qytetarëve
 - 3.5 Ndryshimet globale ekonomike dhe korrupsioni
4. Gjetjet kryesore
5. Rekomandime

**Autorë:**

Gladiola Lleshi
Rigels Xhemollari

Ky raport është hartuar në kuadër të nismës "Qëndresë për Qeverisje të Mirë" zbatuar nga Qëndresa Qytetare dhe mbështetur nga National Endowment For Democracy.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Prill 2022



1. ANALIZA E KONTEKSTIT

Korrupsioni në Shqipëri mbetet një fenomen shqetësues dhe një tregues i impaktit të limituar që strategjitë, politikat dhe kuadri ligjor kanë pasur në adresimin e tij. Disa nga gjetjet e raportit të dhjetorit 2020 të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) tregojnë që kuadri ligjor për parandalimin e korrupsionit të anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe këshilltarëve të tyre politikë, si dhe të policisë, dukshëm gjithëpërfshirës, mbetet kompleks. Në këtë kontekst GRECO ka bërë disa rekomandime dhe pritet që deri më 30 prill 2022 Shqipëria të dorëzojë një raport mbi masat e marra për zbatimin e këtyre rekomandimeve.¹

Por si është situata aktuale e korrupsionit në Shqipëri? *Transparency International (TI)*, K koalicioni Global kundër Korrupsionit nëpërmjet Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2021 raportoi një rënie të Shqipërisë në listën e vendeve më të korruptuara. Shqipëria renditet 110 nga 180 vende, duke shënuar kështu një rënie prej 6 vendesh nga viti 2020. Me 35 nga 100 pikë të mundshme, në rang rajonal Shqipëria u tejkalua nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Krahasimisht me vendet europiane, Shqipëria është pothuajse 50% më poshtë mesatares së këtyre vendeve. Duke vënë në pah rritjen e autoritarizmit në vend, raporti thekson se kufizimi i të drejtave themelore si liria e shprehjes, liria e tubimit dhe aksesit në drejtësi rrezikojnë të dëmtojnë demokracinë dhe të rrisin më tej nivelet e korrupsionit.²

Ky raport u parapri nga ai i ACER nën drejtimin e Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC – Maqedonia e Veriut) dhe projektin SELDI, i cili tregon një pamje mjaft të ngjashme me atë të TI. Në sondazhin e kryer nga ACER, të dhënat treguan se dhënia e rryshetit sipas eksperiencës së qytetarëve ka pësuar rritje nga viti 2019 në 2021. Në vitin 2021 (57.0%) raportohet një rritje prej 12.2% e presionit nga zyrtarët publikë për të marrë rryshfet në krahasim me vitin 2019 (44.8%).³

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) në raportin e fundit tregon se Shqipëria në vitin 2021 shfaq probleme me lirinë e shprehjes, korrupsionin, pandëshkueshmërinë dhe sistemin gjyqësor. Sipas këtij raporti, edhe pse ka pasur tentativa në hetimin e aferave korruptive në vend, këto hetime u penguan si rezultat i burimeve të kufizuara, presionit politik, rrjedhjes së informacionit hetimor dhe sistemit të paorganizuar në tërësi.⁴

Duke marrë shkas nga këto raportime si dhe zhvillimet më të fundit në vend, sondazhi i kryer nga Qendresa Qytetare mbi perceptimet e qytetarëve mbi korrupsionin synon të identifikojë eksperiencat e vetë qytetarëve me aferat korruptive në sektorët e ndryshëm publik, njohuritë mbi strukturat e anti-korrupsionit, qëndrimet e tyre ndaj korrupsionit si dhe besueshmërinë e tyre tek institucionet publike, partitë politike si dhe shoqërinë civile.

1 <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>

2 <https://www.transparency.org/en/cpi/2021/index/alb>

3 https://acer.org.al/wp-content/uploads/2021/09/ACER_SELDI_ENG_CMS-2021-FINAL.pdf

4 <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/albania>



2. METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Gjetjet e këtij raporti bazohen në procesin e vlerësimit të perceptimeve të qytetarëve përsa i përket aspekteve të ndryshme të aferave korruptive në vend. Vlerësimi është realizuar nëpërmjet një sondazhi të publikuar online. Forma e realizimit të pyetësorit u mundësua nëpërmjet softuerit të administrimit të sondazheve "Google Form" duke u mbështetur nëpërmjet facebook ads. Sondazhi nuk u publikua në rrjetet sociale apo web, me qëllim shmangien apo minimizimin në maksimum të mundësisë së plotësimit të sondazhit më shumë se një herë nga i njëjti individ apo mundësinë e shpërndarjes në grupe të cilat ndajnë qëndrime të unifikuara për çështjen.

Mosha e të anketuarëve varionte nga 11.1% mosha 18 – 29 vjeç, 34.7% mosha 29 - 45 vjeç si dhe përqindja më e lartë 54.2% e të anketuarëve ishin 45 - 60 vjeç. Në total 36.6% e të anketuarëve ishin gra dhe vajza dhe 63.4% burra dhe djem. Rreth 2.4% e të pyeturve ishin me arsim tetëvjeçar ose nëntëvjeçar, 25.6% me shkollë të mesme, 46.9% me universitar si dhe 24.9% me arsim pas-universitar.

Totali I anketave: **546**


Grupmosha: **18-60 vjeç**

Shpërndarë në :
TË GJITHË SHQIPERINË

Gjinia: **36.6%** **63.4%**



ARSIMI






3. ANALIZA E DETAJUAR E TË DHËNAVE TË SONDAZHIT

3.1 Besimi i qytetarëve ndaj administratës publike

Mosbesimi i qytetarëve shqiptarë tek qeveria dhe strukturat drejtuese mbetet një problem me rëndësi të veçantë. Kjo mungesë besimi bën që qytetarët të përfshihen në mënyrë informale në marrjen e shërbimeve publike.⁵ Sipas sondazhit të plotësuar nga 546 qytetarë, gjetjet tregojnë se, **65.5% e të anketuarve vlerësojnë që shumica e zyrtarëve janë të korruptuar**. Kjo tregon një nivel të lartë të mungesës së besimit të qytetarëve tek administrata publike. Për më tepër, 27.8% e të anketuarëve treguan një qëndrim absolut duke cilësuar të gjithë zyrtarët si të korruptuar. Ndërkohë, 5.6% e tyre u shprehën që pak zyrtarë janë të korruptuar dhe një përqindje e vogël e qytetarëve prej 0.8% besojnë që pothuajse asnjë nga zyrtarët nuk është i korruptuar dhe 0.4% e tyre preferuan të mos përgjigjen.



Ky mosbesim vlerësohet që vjen si rrjedhje e përvojave personale, ku 42.6% e qytetarëve shprehen që dikush ju ka kërkuar para, dhuratë ose një nder. Ndërkohë, 40.1% e tyre shprehen që mosperputhja midis të ardhurave të ulta të zyrtarëve dhe standarteve të larta të jetesës së tyre ka ndikuar thellësisht në krijimin e një marrëdhënie mosbesimi me strukturat drejtuese të vendit si dhe zyrtarët e administratës publike. Dukshëm, ky është një fenomen që bëhet pjesë e tryezave të diskutimit informal ku 13% e të anketuarëve vlerësojnë që perceptimet e tyre mbi përhapjen e korrupsionit janë të ndikuara nga bisedat me të afërmit dhe njerëzit që njohin. Ndërkohë, 3.2% e të anketuarëve shprehen që media ka luajtur një rol kyç në formimin e perceptimeve të tyre mbi aferat korruptive në vend si dhe në krijimin e një marrëdhënie mosbesimi me strukturat drejtuese ndërsa 1.1% e të anketuarëve preferuan të mos përgjigjen. Në këtë aspekt qeveria shqiptare ka ndërmarrë disa fushata dhe prezantuar mjete të reja me qëllim parandalimin si dhe luftën ndaj korrupsionit.




3.2 Digjitalizimi i shërbimeve dhe korrupsioni

Digjitalizimi si një ndër këto mjete mund të reduktojë korrupsionin nëpërmjet rritjes së transparencës, limitimit të kontaktit njerëzori dhe uljes së diskrecionit.⁶

Qeveria shqiptare ndër vite ka ndërmarrë një sërë nismash në sajë të digjitalizimit të shërbimeve publike. Sipas raportimeve të fundit 95% e shërbimeve administrative mund të kryhen online, ku 377 shërbime nisin dhe përfundjnë online duke evituar kështu kontaktin njerëzor. 66% e formularëve të formularëve për aplikime të ndryshme të shërbimeve publike administrative kryhen automatikisht nëpërmjet portalit e-Albania.

Për më tepër, Shqipëria përdor një sistem elektronik përgjatë procedurave të prokurimeve publike, proces i cili ndiqet nga Agjencia e Prokurimeve Publike. Mbetet shqetësuese sesi një sistem tërësisht i digjitalizuar është subjekt i akuzave të aferave më të mëdha korruptive në vend. Kjo është një tregues mjaft i qartë sesi digjitalizimi i shërbimeve nëse nuk vjen njëkohësisht me zbatimin e reformave, luftën ndaj korrupsionit dhe me vullnetin politik për konsolidimin e një shteti demokratik, nuk prodhon efekt në reduktimin e aferave korruptive në vend të cilat minojnë themelet e shtetit të së drejtës.



Mendoni që dixhitalizimi i shërbimeve ka reduktuar nivelin e korrupsionit?



Cila është rruga më e thjeshtë për të zgjidhur një problem në Shqipëri?



Perceptimi i qytetarëve nga ana tjetër tregon që 61.4% e të anketuarëve mendojnë që digjitalizimi nuk e ka reduktuar nivelin e korrupsionit. Kryesisht 78% e të anketuarëve u shprehën që rruga më e thjeshtë për të zgjidhur një problem në Shqipëri është nëpërmjet dhënies së parave ndaj një zyrtari. Shumica e të anketuarëve, 45.4% e tyre rrëfejnë që kur janë përballur me zyrtarë publikë në të shumën e rasteve u është dashur të japin para ose dhurata në këmbim të zgjidhjes së një problemi. Ndërkohë, 13.7% e tyre pohuan që gjithmonë kanë dhënë rryshfet, 24.9% vetëm në raste të veçanta dhe 16.1% preferuan të mos përgjigjen.



Nga ana tjetër, kur të anketuarit u vendosën para pyetjes hipotetike sesi do të vepronin përballë rastit kur një zyrtar kërkon drejtpërsëdrejti para në

⁶ <https://oecd-development-matters.org/2021/08/04/digitalisation-as-an-anti-corruption-strategy-what-are-the-integrity-dividends-of-going-digital/#:~:text=Digitalisation%20can%20disrupt%20corruption%20by,and%20data%2Dsavvy%20civil%20society>



këmbim të zgjidhjes së një problemi, rezultatet ndryshonin nga realiteti i lartpërmendur. 46.2% e tyre u shprehën që nuk do të paguanin nëse do të kishin një mënyrë tjetër për të zgjidhur problemin, 18.3% e tyre do ta paguanin nëse do të mund ta përballonin dhe 14.9% do ta paguanin padyshim. Vetëm 17.5% e të anketuarëve u shprehën që nuk do të paguanin rryshfet në asnjë mënyrë si dhe 3% e tyre preferuan të mos përgjigjen. Kjo demonstron që masa dërmuese prej **79.4% e të anketuarëve ndihen të detyruar për të dhënë rryshfet në mungesë të alternativave dhe pozicionit të disfavorshëm në të cilin ndodhen.**

3.3 Masat anti-korrupsion, efektiviteti dhe njohuritë e qytetarëve


Në këto 30 vite, vërehet që qeveria shqiptare vazhdimisht ka ndërmarrë fushata dhe nisma të cilat synonin të ndikonin pozitivisht në uljen e nivelit të korrupsionit në vend. Ish-kryeministri Sali Berisha mbërriti në pushtet duke premtuar përpjekje ndaj luftës dhe shpali fushatën “Me Duar të Pastra”. Ndërkohë, në Maj 2021, SHBA si një ndër partnerët më mëdhenj të vendit shpalli *non-grata* duke i ndaluar kështu hyrjen në territorin Amerikan ish-kryeministrit Berisha dhe familjes së tij me arsyetimin që ky vendim u ndërmorr si pasojë e veprave të korrupsionit të kryera nga ish-kryeministri.

Si pasojë e rotacionit politik, me ardhjen në pushtet të qeverisë Rama në vitin 2013, u prezantuan disa nisma, strategji dhe plane veprimi të cilat në focus kanë aferat korruptive në vend apo fushata të dedikuara sektorëve të veçantë si mjekësia dhe policia. Kështu, qeveria ofron portalin “Stop Korrupsionit”, “Shqipëria që Duam” si dhe instrumenta të tjerë që kanë si synim ndërveprimin me qytetarët dhe ofrimin e hapsirave ku ata mund të denoncojnë raste korruptive.

Për më tepër, aktualisht ndodhet në fuqi Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 si dhe Plani i Veprimit 2020-2023 në zbatim të kësaj strategjie.⁷

Përsa i përket këtyre masave anti-korrupsion të ndërmarra ndër vite nga qeveria shqiptare, **57.2% e të anketuarëve i cilësojnë si të pavlefshme**, 34.7% si pjesërisht të vlefshme dhe vetëm 3.8% i cilësojnë masat dhe strategjitë e anti-korrupsionit si efektive. Ndërkohë 4.3% e të anketuarëve preferuan të mos përgjigjen.

Si i vlerësoni masat dhe strategjitë anti korrupsion te qeverisë?




⁷ https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1.-PLANI-I-VEPRIMIT-ANTIKORRUPSION-2020-2023_AL.pdf




Vënë para dilemës nëse do ta denonconin apo jo një aferë 48% e të anketuarëve pohuan që do ta denonconin, 22.9% u shprehën që nuk do ta denonconin dhe 29.1% preferuan të mos përgjigjen. Më tej, përsa i përket njohurive mbi strukturat anti-korrupsion dhe institucionet adekuate ku qytetarët mund të drejtohen për të raportuar një aferë korruptive, 52.3% e të anketurëve u shprehën që dinin se ku të drejtohen dhe 47.7% nuk kishin njohuri mbi këto struktura.

A dini ku të drejtoheni në rast se identifikoni një aferë korruptive?




A do e denonconit një aferë korruptive?



Ajo që vërehet pozitivisht është që **62.8%** e të anketuarëve është që nëse do të ishin zyrtar publik në një pozicion që paguhet pak në këmbim të zgjidhjes së një problemi **nuk do të pranonin rryshfet në formën e parave**, dhuratës apo një nderi. Ndërkohë mbetet shqetësuese sesi 21.6% e të anketuarëve u shprehën që nuk do të pranonin asnjë nga format e rryshfetit nëse përbënte shkelje ligjore. Për më tepër, 7.1% e të anketuarëve zgjodhën të mos përgjigjen dhe 3.2% u shprehën që do të pranonin rryshfet. Kjo ilustron që ka ende një qëndrim tolerant të qytetarëve ndaj korrupsionit.


Si mendoni se luftohet korrupsioni ne Shqipëri?



Përsa i përket adresimit të fenomenit të korrupsionit në Shqipëri, 59.5% e të anketuarëve u shprehën që korrupsioni në Shqipëri mund të luftohet vetëm nëpërmjet ashpërsimit të masave dhe ndëshkimeve penale, 14.2% besojnë që kursi i duhur i veprimit është nëpërmjet ndërgjegjesimit të popullatës për të mos kryer korrupsion. Më tej, 21.8% besojnë që korrupsioni në Shqipëri mund të luftohet nëpërmjet ndërmarrjes së masave parandaluese dhe 4.5% e të anketuarëve preferuan të mos përgjigjen.


3.4 Nivelet e korrupsionit dhe e ardhmja sipas qytetarëve

Në sondazhin e kryer, të anketuarit janë pyetur mbi përshtypjet e tyre mbi nivelin e korrupsionit sipas 6 sektorëve të ndryshëm. Vërehet që të anketuarit vlerësojnë përhapjen më të lartë të korrupsionit tek partitë politike ku 83.4% dhanë vlerësimin maksimal. Më pas, sipas përqindjeve të vlerësimit, si më të korruptuar cilësohen sektori i shëndetësisë (66.2%), administrata publike (64.1%), policia (56%), shoqëria civile (38%) dhe sektori i arsimit dhe edukimit (35.2%).





Në mbështetje dhe të raportit të GRECO dhjetor 2020, 41.1% e qytetarëve vlerësojnë që janë zyrtarët publikë më të korruptuar. Gjithashtu, 37.4% e tyre vlerësojnë që gjyqtarët dhe prokuroret si më të korruptuarit. Përqindje të tjera më të vogla u atribuohen edhe zyrtarëve të bashkive (6%), doganierëve (4.7%), zyrtarëve të taksave (4.3%), zyrtarëve të policisë (2.3%), zyrtarëve të universiteteve (1.3%) dhe këshilltarëve bashkiakë (0.8%).

Sipas jush, cilët zyrtarë publikë janë më të korruptuar? zgjidhni vetëm një opsion.





Në retrospektivë, kur të anketuarit u pyetën se çfarë ka pësuar korrupsioni në 8 vitet e fundit, masa dërmuese e **78.2% e të anketuarëve vlerësuan që korrupsioni ka pësuar rritje** dhe 13.1% u shprehën se nivelet e korrupsionit kanë mbetur konstante. Ndërkohë vetëm 6.6% e të anketuarëve mendojnë që niveli i korrupsionit ka pësuar ulje 8 vitet e fundit si dhe 2.1% e të anketuarëve preferuan të mos përgjigjen.



Plogështia e qytetarëve shqiptarë, mungesa e besimit për ndryshim ilustron më së miri në përgjigjet e tyre sesi i shikojnë të ardhmen e nivelit të korrupsionit në vend. 22.4% e të anketuarëve u shprehën që përhapja e gjerë e korrupsionit nuk mund të ulët, masa dërmuese prej 37.4% besojnë që korrupsioni do të ekzistojë gjithmonë në Shqipëri edhe pse mund të ulët në një farë niveli. Vetëm 10.3% e të anketuarëve besojnë që korrupsioni në Shqipëri mund të çrrënjohet tërësisht si dhe 1.1% e tyre preferuan të mos përgjigjen.


3.5 Ndryshimet globale ekonomike dhe korrupsioni

Pandemia globale Covid-19, tensionet gjeopolitike si dhe rritja e inflacionit janë disa nga zhvillimet e fundit globale që kanë tronditur ekonominë e vendeve duke përfshirë kështu dhe Shqipërinë. Qytetarët shqipëtarë të gjendur para çmimeve të rritura si pasojë e këtyre zhvillimeve globale si dhe ato në vend të cilat rezultuan në rritjen e kostos së jetesës duke nxjerrë në pah më tej pabarazitë ekonomike dhe thelluar nivelet e varfërisë, u angazhuan dhe protesuan rritjen e çmimeve.

Këto protesta me një pjesëmarrje masive të qytetarëve, të cilat u zhvilluan në periudhën Mars-Prill 2022 dukshëm prodhuan efekte pozitive duke çuar në uljen e çmimeve dhe reagimin e institucioneve kyçe në vend për ndërmarrjen e veprimeve në adresimin e krizës ekonomike të pashmangshme që këto ndryshime ekonomike sjellin në jetët e qytetarëve.

Në sondazhin e kryer nga Qendresa Qytetare, kur të anketuarit u pyetën se cilat janë arsyt pse çmimet kanë pësuar rritje, 33.5% e tyre cilësojnë korrupsionin si faktor kryesor, 6.4% e qytetarëve mendojnë që këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e zhvillimeve globale dhe masa dërmuese prej 59.6% mendojnë që të dy këta faktorë të ndërthurur kanë luajtur rol kyç në zhvillimet ekonomike në vend. Ndërkohë, 0.6% e të anketuarëve preferuan të mos përgjigjen.

Pse mendoni që çmimet janë rritur?



Ky qëndrim i qytetarëve është tregues domethënës i nivelit të mosbesimit të tyre ndaj qeverisë dhe strukturave drejtuese. Pavarësisht zhvillimeve globale të cilat kanë qënë faktor ndikues në ekonominë e të gjitha vendeve, vërehet që në Shqipëri prevalon ende besimi që zhvillimet më të mëdha në vend vijnë si pasojë e veprimtarisë së brendshme shtetërore. Krahasimisht me vendet evropiane, ku Shqipëria renditet 50% poshtë mesatares së këtyre vendeve në indeksin e Perceptimit të Korrupsionit sipas raportit të TI, qytetarët europianë janë më të ndërgjegjësuar mbi ndikimin e zhvillimeve globale si shkak i besimit të tyre ndaj strukturave drejtuese.



4. GJETJET KRYESORE



Sipas sondazhit të Qëndresës Qytetare 65.5% e qytetarëve vlerësojnë që shumica e zyrtarëve janë të korruptuar duke ilustruar kështu një nivel të lartë mosbesimi ndaj qeverisë dhe strukturave drejtuese.



79.4% e të anketuarëve ndihen të detyruar për të dhënë rryshfet në mungesë të alternativave dhe pozicionit të disfavorshëm në të cilin ndodhen.



Vërehet pozitivisht që 62.8% e të anketuarëve nuk do të praninin rryshfet në formën e parave, dhuratës apo një nderi nëse do të ishin në rolin e një zyrtari publik.



Përsa i përket këtyre masave anti-korrupsion të ndërmarra ndër vite nga qeveria shqiptare, 57.2% e të anketuarëve i cilësojnë si të pavlefshme, një tregues i impaktit të limituar që këto masa kanë pasur në përvojat e qytetarëve.



78.2% e të anketuarëve vlerësuan që korrupsioni ka pësuar rritje 8 vitet e fundit dhe 58.9% e të anketuarëve besojnë që korrupsioni do të ekzistojë gjithmonë në Shqipëri edhe pse një pjesë e tyre besojnë që nivelet e korrupsionit mund të pësojnë njëfarë ulje.



52.3% e të anketuarëve u shprehen që janë të informuar mbi strukturat anti-korrupsion dhe institucionet adekuate për të denoncuar një aferë korruptive dhe 47.7% nuk kishin njohuri mbi këto struktura.



Në vlerësimin e arsyeve që kanë rezultuar në rritjen e çmimeve, 33.5% e qytetarëve cilësojnë korrupsionin si faktor kryesor, 6.4% zhvillimet globale dhe masa dërmuese prej 59.6% mendojnë që të dy këta faktorë të ndërthurur kanë luajtur rol kyç në zhvillimet ekonomike në vend. Ndërkohë, 0.6% e të anketuarëve preferuan të mos përgjigjen.



REKOMANDIME



Administrata Publike shqiptare ka nevojë të reformohet në dobi të performancës, transparencës, pavarësisë dhe distancimit nga urdhrat politike.



SPAK dhe institucionet e reja të drejtësisë duhet të përshpejtojnë punën e tyre për të ndëshkuar zyrtarë të niveleve të larta të cilët janë të përfshirë në afere korruptive apo ushtrim të ndikimit tek zyrtarët në varësi të tyre për përfshirje në korrupsion.



ILDKPKI bazuar në të dhënat disa vjecare që disponon mbi pasuritë e zyrtarëve dhe politikanëve shqiptarë dhe në rolin e ri si institucion përgjegjës për sinjalizimin e korrupsionit në vend duhet të marrë një rol më aktiv në proceset hetuese dhe ndëshkuese të zyrtarëve që kanë vendosur pasuri të paligjshme në sajë të konfliktit të interesit apo konsumimit të korrupsionit.



Duhet të rritet niveli dhe numri i shërbimeve të ofruara në rrugë elektronike jo vetëm në Tiranë por edhe në rrethe, ku në fokus të jenë institucionet më të targetuara për korrupsion, si tatimet, kadastra apo doganat.



Ministria e Drejtësisë si institucioni koordinues në luftën ndaj korrupsionit duhet të intensifikojë përpjekjet për luftën ndaj këtij fenomeni duke rritur kapacitetet dhe numrin e koordinatorëve kombëtarë kundër korrupsionit.



Media dhe shoqëria civile duhet të luajë një rol aktiv në edukimin e qytetarëve dhe kryesisht të rinjve kundër kulturës së korrupsionit dhe në kritikën ndaj zyrtarëve të korruptuar.

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD